

nr 1849
14.10.2025



Sele Jasht Bashke
14.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 877/1 prot.

Gjirokastër, më 10.10.2025

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara te Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara te Prefekti i qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 57, datë 30.09.2025 “Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimit të buxhetit për periudhën 8-mujore 2025”, konfirmohet.
2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 58, datë 30.09.2025 “Për ndryshime në buxhetin e miratuar të vitit 2025”, konfirmohet.
3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 59, datë 30.09.2025 “Për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 60, datë 30.09.2025 “Për miratimin në parim të implementimit të projektit me titull ‘Ariadne’ në kuadër të instrumentit të para anëtarësimit IPA III, Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Greqi - Shqiperi 2021-2027”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin.

PREFEKTI



Odise Kote